

**VENDIM**  
**Nr. 463, datë 9.7.2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 138, DATË 14.3.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,**  
**“PËR PROCEDURËN E TRAJTIMIT TË ARMËVE, TEKNIKËS DHE PAJISJEVE TË FORCAVE**  
**TË ARMATOSURA, TË HEQURA NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kreu X i vendimit nr. 138, datë 14.3.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“X. Nga të ardhurat që do të sigurohen nga shitja e armëve, teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve eksplozive të Forcave të Armatosura për përdorim ushtarak, për përdorim joushtarak, për çmontim e çmilitarizim, nga shitja e pjesëve të këmbimit të teknikës dhe pajisjeve, shitja e materialeve që përfitohen nga asgjësimi e shkatërrimi i armëve, teknikës, pajisjeve, municioneve dhe lëndëve eksplozive, 10 (dhjetë) për qind do të derdhet në buxhetin e shtetit dhe 90 (nëntëdhjetë) për qind do të përdoret nga Ministria e Mbrojtjes, si të ardhura jashtë limitit, për:

- a) përballimin e kostove të parashikuara për këto veprimtari;
- b) përballimin e kostove të pastrimit të poligoneve dhe hotspotëve;
- c) investime për modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
- ç) ndërtim e rikonstrukcione të objekteve të Forcave të Armatosura.”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**